



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Shkurt 2021

Nr: 97

VENDIM

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË Z. XHAVIT ZHUZHI PËR REGJISTRIMIN SI
SUBJEKT ZGJEDHOR TË PARTISË EMIGRACIONI SHQIPTAR NË ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga z. Xhavit Zhuzhi, për regjistrimin si subjekt zgjedhor Partinë Emigracioni Shqiptar, në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Z. Xhavit Zhuzhi, në cilësinë e Kryetarit të Partisë Emigracionit Shqiptar, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021, administruar me nr. 289 prot., datë 13.01.2021.

Ky dokumentacioni ndonëse respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, nuk përmbush kërkesat e pikës 2 të këtij neni. Konkretisht vërtetimi lëshuar nga Zyra e regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është i datës 16.06.2008 fotokopje.

Dokumentacioni i paraqitur nga z. Xhavit Zhuzhi, për regjistrimin e Partisë Emigracioni Shqiptar, për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, përbëhet si më poshtë:



Data: 22 Shkurt 2021

Nr. 97

Për shqyrtimin e kërkesës së z. Xhavit Zhuzhi për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Emigracioni Shqiptar në zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021

- a) Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 16.06.2008, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia Emigracionit Shqiptar, me Kryetar z. Xhavit Zhuzhi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) specimeni i vulës së partisë;
- c) emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- ç) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- d) Shkresa kthim-përgjigje nga Kryeministria nr.107 prot., datë 13.01.2017;
- dh) Shkresa kthim përgjigje nga Ministria e Punëve të jashtme nr.5090/1 prot., datë 23.04.2014;
- e) Shkresa kthim përgjigje nga Ministria e Brendshme nr. 80/2 prot., datë 26.03.2009;
- ë) Shkresa kthim përgjigje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.2405/1 prot., datë 13.03.2014;
- f) Shkresa kthim përgjigje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.4-8 prot., datë 29.01.2007, bashkëlidhur urdhërin nr.39/1, datë 16.07.1998 “Për miratimin e krijimit të Partisë Emigracioni Shqiptar;
- g) Shkresa kthim përgjigje nga Ministria e Drejtësisë nr. 7906/1, datë 24.01.2005;
- gj) Shkresa kthim përgjigje nga Ministria e Financave nr.3594/1, datë 30.05.2005;
- h) Shkresat kthim përgjigje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, datë 766/1 prot., datë 01.10.2002, nr.1894/1 prot., datë 18.12.2006 dhe nr.538/1 prot., datë 22.04.2014;
- i) Shkresa kthim përgjigje nga Zyra e Prokurorit të Përgjigjtshëm nr.356/1 prot., datë 29.03.2007;

Kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga z. Xhavit Zhuzhi, kryetar i Partisë Emigracioni Shqiptar, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, e 92/2 pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.674 prot., datë 30.01.2021 i ka kërkuar zotit Xhavit Zhuzhi, për të plotësuar kërkesën për regjistrimin e Partisë Emigracioni Shqiptar në zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021, sipas dispozitave të nenit 64 dhe 92/2 të të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 64 pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përkatësisht data 15.02.2021, z. Xhavit Zhuzhi nuk ka depozituar dokumentacionin plotësues për regjistrimin e partisë për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021. Referuar faqes zyrtare të Postës Shqiptare, rezulton se z. Zhuzhi, ka marrë dijëni në datën 03.02.2021.



Pranë KQZ-së është depozituar kërkesa dhe dokumentacionin përkatës për regjistrimin e Partisë Emigracioni Shqiptar, nëpërmjet Kryetarit të saj z. Kostaq Papa, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, i cili respekton në mënyrë të plotë, në formë dhe përmbajtje, kërkesat e nenit 64 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Nga ky dokumentacion, administruar me nr. 785 prot., datë 02.02.2021, provohet nga vërtetimi i zyrës së regjistrimit të Partive Politike, i datës 18.01.2021, se “Partia Emigracioni Shqiptar” ka Kryetar z. Kostaq Papa.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se z. Xhavit Zhuzhi, nuk legjitimohet si Kryetar i Partisë Emigracioni Shqiptar”, si dhe nuk legjitimohet të kërkojë regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Mospranimin e kërkesës nga z. Xhavit Zhuzhi, për regjistrimin e Partisë Emigracioni Shqiptar”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

